




<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> <b>REPUBLIKA KOSOVA / RÉPUBLIQUE DE KOSOVO</b> <b>AGJENCIJA KUNDER KORRUPSIONIT</b> <b>AGENCE PROTIV KORUPCIJE</b> <b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b>	
Dep.	DPK
Dep.	03-02/3456/17
Dep.	24-10-2017
Nr. i faq	
Broj stranica	
Nr. pages	
	PRISHTINE
02	
Data	
Datum	
Date	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 23.10.2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mylllet rasti me Nr. AKK-03-02-2543/17 për z. Vaxhid Sadriu – Sekretar në Universitetin “Kadri Zeka” Gjilan, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.**

**II. Rasti mund të rihapecet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur, me nr. protokoli AKK-03-02-2543/17 për Zyrtarin e lartë, z. Vaxhid Sadriu, Sekretar ne Universitetin publik “Kadri Zeka” ne Gjilan ka qenë një situatë të dyshuar për konflikt interesit, për shkak se është dyshuar se z. Sadriu gjatë kohës së ushtrimit të funksionit U.D. i Sekretarit te përgjithshëm te UP “Hasan Prishtina” në Prishtinë, ka mundësuar punësimin e gruas së tij zonjës Nexharije Sadriu në degën e UP-së në Gjilan. Ky ka qenë pretendimi nga pala e tretë për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për z. Vaxhid Sadriu.**

Agjencia kundër Korruption pas pranimit të pretendimeve nga pala e tretë me dyshimin për konflikt interesit, këtë rast e ka hap si të dyshuar, por gjatë procesit të hetimit është konstatuar se z. Sadriu nuk ka pas rol vendimmarrës në asnjë fazë të procesit të punësimit të gruas së tij, sepse ai praktikisht ka qenë me detyra dhe kompetanca krejt tjera, që fare nuk kanë pasur të bëjnë me këtë proces.

Zonja Nexharije Sadriu është punësuar në kuadër të Universitetit të Prishtinës me 11.09.2012 në pozitën “Zyrtare për arkiva, shërbime postare”, pas një procesi të rekrutimit që ka organizuar Zyra e personelit të Universitetit të Prishtinës (Akt emërimi me numër të referencës 2/499).

Në këtë kohë z. Vaxhid Sadriu ka qenë në detyrën e Sekretarit të Fakultetit Filologjik në Universitetin e Prishtinës, që praktikisht tregon se as nuk ka qenë pjesë e komisionit të pranimit e as nuk ka pas të bëjë me procesin e rekrutimit të punonjësve të rinjë, për shkak se kjo është kompetencë e Zyrës së personelit të Universitetit të Prishtinës.



Pretendimi i palës së tretë se pranimi i znj.Sadriu në këtë pozitë lidhet me kohën kur ztr. Vaxhid Sadriu ka qenë ushtrues detyre i Sekretarit të Universitetit të Prishtinës po ashtu nuk qëndron, sepse kjo kohë lidhet me periudhën kur z.Sadriu nuk ishte me U.D. i Sekretarit të Universitetit të Prishtinës. Në kohën e punësimit të zonjës Sadriu, në pozitën e ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Universitetit të Prishtinës ka qenë i ngarkuar z.Milaim Mazreku. I njëjtë edhe e ka nënshkruar Akt Emrimin e zonjës Nexharije Sadriu, që mbanë numrin e protokollit; Ref.nr.2/499, i datës 11.09.2012, (DPK-03-02/3205/17).

Ndërsa kalimi i zotriut Vaxhid Sadriu në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit Publik “Kadri Zeka” të Gjilanit është bërë me Vendim të datës 10.10 2013 të nënshkruar nga Rektori i atëhershëm z.Arben Demaku.

Kur është zgjedhur z.Sadriu në këtë pozitë, ai praktikisht e ka gjetur të punësuar zonjën Sadriu në Universitetin e Gjilanit. Kjo përfaktin se MASHT-i kishte nxjerr një Marrëveshje Mirëkuptimi mes Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Universitetit “Kadri Zeka” të Gjilanit (dt/13.05.2015, nr.01/531) në të cilin, në Nenin 5, kur flitet për Personalin administrativ, pos të tjerash, shprehimisht thuhet: ”Personeli administrativ i Fakultetit të Edukimit, Fakultetit juridik dhe Fakultetit Ekonomik në Gjilan nga data 15.05.2015 bartet/transferohet me të drejta të njëjtë si personel administrativ në UKZ.”

Tani kjo ka bërë që zotriu Vaxhid Sadriu dhe zonja Nexhavere Sadriu të jenë pjesë e një institucioni, në këtë rast, “Universitetit Kadri Zeka” në Gjilan.

Pozitat që ushtrojnë këta dy, mund të kenë konflikt “rast pas rasti” te interesit. Në situata të tilla duke qenë se z.Sadriu është në pozitë me të lartë dhe hynë ne mesin e zyrtareve të lartë publik, është i obliguar që të bëjë deklarimin e konfliktit të interesit dhe të tërhoqet nga një vendimmarrje që do të sillte situata me konflikt interesit. Ndërsa në qoftë se eprori ose institucioni epror i dy te punësuarve, konstaton se këto pozita kanë konflikt të vazhdueshëm të interesit, atëherë mund që me masa të brendshme të bëjë kufizimin ose edhe transferimin në kryerjen e detyrave tjera zyrtare.

## II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Shaip Havalli /